



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare



Komisioni Evropian*

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT


2 TETOR 2023

* Vrojtimet e besimit bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e Komisionit Evropian për harmonizimin e Vrojtimeve të Besimit.

VROJTIMI I BESIMIT TË BIZNESIT DHE TË KONSUMATORIT

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) regjistroi rënie me 2.4 pikë në muajin shtator, në nivelin 111.1 (Grafik 1). Pavarësisht luhatjeve të muajve të fundit, niveli i TNE-së vijon të qëndrojë ndjeshëm mbi mesataren historike (+11.1 pikë). Rënia e TNE-së këtë muaj u ndikua kryesisht nga përkeqësimi i treguesit të besimit në sektorin e *ndërtimit*. Negativisht kontribuoi edhe rënia e besimit në sektorët e shërbimeve dhe të tregtisë. Në të kundërt, treguesi i besimit të *industrisë* dha kontribut pozitiv këtë muaj, ndërsa besimi i *konsumatorëve* mbeti i pandryshuar në krahasim me një muaj më parë (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të *industrisë* (TBI) u rrit me 2.3 pikë përqindje në muajin shtator, duke qëndruar aktualisht 10.4 pikë mbi mesataren historike (Grafiku 2). Bizneset e *industrisë* raportuan të përmirësuar si kërkesën nga *kontratat porositëse* vendase e të eksportit, ashtu edhe *prodhimin aktual*. Gjithashtu, pritet e bizneseve të *industrisë* për *prodhimin* në të ardhmen kanë regjistruar rritje në shtator, ndërsa pritet për *punësimin* dhe çmimet që do të vendosin në të ardhmen janë në rënie (Tabelë 2, sektori i *industrisë*).

Treguesi i besimit në *ndërtim* (TBN) regjistroi rënie me 9.9 pikë përqindje në shtator. Megjithatë, niveli i tij vijon të qëndrojë në nivele të larta, 18 pikë përqindje mbi mesataren historike (Grafik 2). Rënia e TBN-së u përcaktua kryesisht nga vlerësime më pak optimiste për *aktivitetin aktual* *ndërtues*. Vlerësimi për nivelin e *porosive* regjistroi rënie, por në masë më të ulët. Gjithashtu, pritet për *punësimin* në të ardhmen kanë regjistruar rënie. Pritet për çmimet që do të vendosin në të ardhmen kanë pësuar rritje të lehtë (Tabelë 2, sektori i *ndërtimit*).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korriguar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSH) ra me 4.6 pikë përqindje në shtator, por duke vijuar të qëndrojë mbi mesataren historike, me 19 pikë përqindje (Grafik 2). Në rënien e TBSH-së kontribuan njësoj vlerësimet më pak optimiste të bizneseve si për *ecurinë aktuale* të *aktivitetit* të tyre, ashtu edhe për *nivelin* e kërkesës. Gjithashtu, pritet për kërkesën dhe nivelin e *punësimit* në të ardhmen vlerësohen në renie nga bizneset e shërbimeve. Pritet e tyre për *ecurinë* e çmimeve në të ardhmen janë ulur (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) regjistroi renie të lehtë me 0.2 pikë përqindje në muajin shtator. Aktualisht, niveli i TBT-së qëndron 12 pikë mbi mesataren historike (Grafik 2). Në rënien mujore ndikuan pritet më pesimiste për *punësimin* në të ardhmen. Nga ana tjeter, vlerësimet për *ecurinë aktuale* të biznesit të tyre shënuan rritje të lehtë. Pritet për çmimet në të ardhmen u vlerësuan me rritje (Tabelë 2, sektori i tregtisë).


Treguesi i besimit konsumator (TBK) mbeti i pandryshuar në shtator në krahasim me një muaj më parë dhe shumë pranë nivilit të mesatares së tij historike (Grafik 2). Komponentët përbërës të TBK-së këtë muaj dhanë kontributë me kahe të ndryshme: pritet për *blerjet* në *shuma* të *mëdha* dhe për *situatën financiare* në të ardhmen u rritën, ndërsa vlerësimi për *blerjet aktuale* në *shuma* të *mëdha* dhe pritet për *gjendjen* e *përgjithshme* të ekonomisë në të ardhmen u ulën (Tabelë 2, konsumatorët).

Të dhënat me frekuencë tremujore¹ tregojnë për nivele të larta të *gjendjes financiare* të bizneseve sipas sektorëve, afër vlerave maksimale përkatëse, megjithëse me renie në krahasim me tremujorin e dytë. Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve është rritur, në krahasim me tremujorin e dytë, në sektorin e

¹ Pyetjet mbi normën e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe gjendjen financiare kanë frekuencë tremujore. Ato përfshihen në pyetësorët e bizneseve në muajt mars, qershor, shtator dhe dhjetor.


shërbimeve (+1.1 pp) e të tregtisë (+3.6 pp) dhe ulur në sektorin e ndërtimit (-4.1 pp) dhe të industrisë (-1.1 pp).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve, gjatë muajve të fundit




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6. Blerjet në shuma të mëdha të konsumatorëve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve *

| | Vlerat | | | | | | 2023 | | | Situata aktuale | |
|------------|--------|-------|-------|-------|---------|--------|-------|---------|-----------------|-----------------|--|
| | min | mes | maks | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Koniunkturale** | Strukturore*** | |
| Industri | -60.4 | -11.1 | 7.0 | 7.0 | 6.8 | 2.2 | -3.0 | -0.6 | ↑ | + | |
| Ndërtim | -58.1 | -25.9 | 9.8 | 7.8 | 9.8 | -1.7 | 2.1 | -7.9 | ↓ | ++ | |
| Shërbime | -45.5 | 7.0 | 35.8 | 35.8 | 33.5 | 22.8 | 30.7 | 26.1 | ↓ | ++ | |
| Tregti | -32.6 | -1.4 | 17.4 | 12.5 | 13.0 | 13.8 | 11.0 | 10.8 | ↓ | ++ | |
| Konsumator | -40.2 | -26.6 | -16.3 | -25.3 | -24.9 | -26.9 | -27.4 | -27.3 | = | - | |

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*]) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga muaji maj 2016.

**) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++) kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (-), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje)

| | 2023 | | | | | | | | | |
|---|-------|--------|-------|-------|-------|-------|--------|-------|---------|--|
| | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qersh | Korrik | Gusht | Shtator | |
| INDUSTRIA | | | | | | | | | | |
| Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së) | 15.9 | 16.7 | 21.9 | 26.5 | 30.2 | 26.9 | 24.3 | 20.6 | 22.3 | |
| Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së) | -15.8 | -9.3 | -7.6 | -1.1 | -4.3 | -3.9 | -8.8 | -13.4 | -11.1 | |
| Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së) | -19.6 | -17.7 | -8.8 | -10.0 | -5.1 | -2.6 | -8.9 | -16.1 | -13.1 | |
| Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4) | -2.4 | -6.1 | -1.1 | -4.5 | -3.0 | 0.9 | 0.0 | 4.5 | 4.2 | |
| Prodhimi pritje (pyetja 5) | 33.6 | 33.1 | 39.9 | 37.6 | 33.3 | 29.6 | 30.9 | 24.4 | 29.2 | |
| Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6) | 32.2 | 18.4 | 15.0 | 16.3 | 18.2 | 18.7 | 16.8 | 8.2 | -9.3 | |
| Punësimi pritje (pyetja 7) | 10.2 | 11.6 | 15.3 | 17.4 | 16.3 | 12.7 | 8.8 | 10.6 | 9.0 | |
| NDËRTIMI | | | | | | | | | | |
| Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së) | 12.1 | 20.3 | 22.8 | 22.4 | 29.9 | 30.9 | 15.4 | 22.5 | 7.1 | |
| Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së) | -26.4 | -22.0 | -16.7 | -15.9 | -14.3 | -11.4 | -18.8 | -18.3 | -22.9 | |
| Punësimi pritje (pyetja 4) | 12.8 | 19.4 | 18.7 | 15.6 | 13.7 | 15.8 | 9.3 | 12.2 | 4.5 | |
| Çmimet pritje (pyetja 5) | 25.6 | 34.6 | 28.5 | 19.4 | 18.6 | 26.3 | 25.7 | 17.6 | 21.1 | |
| SHËRBIME | | | | | | | | | | |
| Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së) | 20.2 | 17.3 | 25.3 | 23.5 | 39.8 | 32.7 | 20.0 | 30.9 | 26.4 | |
| Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së) | 20.8 | 17.5 | 27.6 | 26.4 | 31.9 | 34.3 | 25.7 | 30.6 | 25.8 | |
| Kërkesa pritje (pyetja 3) | 33.0 | 32.1 | 36.4 | 29.4 | 29.6 | 29.3 | 29.9 | 30.6 | 25.4 | |
| Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4) | 10.3 | 5.7 | 10.1 | 12.8 | 17.0 | 16.3 | 15.3 | 11.7 | 6.2 | |
| Punësimi pritje (pyetja 5) | 7.4 | 15.9 | 21.7 | 9.3 | 13.1 | 12.9 | 11.4 | 11.0 | 9.6 | |
| Çmimet pritje (pyetja 6) | 23.8 | 19.6 | 19.4 | 7.6 | 13.8 | 13.4 | 15.9 | 17.7 | 14.4 | |
| TREGTIA | | | | | | | | | | |
| Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së) | 4.9 | 6.4 | 14.7 | 16.4 | 21.4 | 20.5 | 24.2 | 19.1 | 19.2 | |
| Gjendja e inventarëve (pyetja 2) | 2.1 | 5.6 | 2.6 | 3.8 | 5.0 | 0.5 | 0.3 | 4.2 | 0.7 | |
| Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3) | 23.6 | 23.6 | 25.0 | 30.0 | 23.2 | 25.2 | 15.9 | 21.0 | 22.3 | |
| Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4) | 27.3 | 26.4 | 26.4 | 26.7 | 26.4 | 26.3 | 18.7 | 23.7 | 17.2 | |
| Pritje për ecurinë e punësimit (pyetja 5, komponent i TBT-së) | 3.9 | 3.2 | 5.2 | 5.5 | 3.5 | 5.6 | 3.3 | 2.8 | 2.4 | |
| Pritje për ecurinë e çmimeve (pyetja 6) | 22.0 | 15.5 | 13.4 | 9.9 | 22.8 | 13.0 | 18.6 | 7.9 | 17.1 | |
| KONSUMATORI | | | | | | | | | | |
| Situata financiare aktuale (pyetja 1) | -16.6 | -16.5 | -14.6 | -15.0 | -13.6 | -13.5 | -15.7 | -14.7 | -13.9 | |
| Situata financiare pritje (pyetja 2, komponent i TBK-së) | -1.9 | 0.5 | 4.4 | 6.3 | 4.6 | 4.3 | 1.6 | 0.3 | 1.0 | |
| Situata ekonomike aktuale (pyetja 3) | -27.8 | -30.2 | -27.3 | -24.7 | -23.8 | -22.1 | -23.8 | -23.5 | -22.1 | |
| Situata ekonomike pritje (pyetja 4, komponent i TBK-së) | -6.1 | -4.5 | 0.6 | 2.9 | 3.1 | 1.4 | 0.0 | 0.8 | -0.2 | |
| Çmimet aktuale (pyetja 5) | 49.2 | 46.5 | 45.7 | 49.6 | 43.9 | 46.4 | 50.9 | 51.7 | 47.2 | |
| Çmimet pritje (pyetja 6) | -2.0 | -4.2 | -6.6 | -4.3 | -7.8 | -5.5 | 0.1 | 3.6 | -2.7 | |
| Papunësia pritje (pyetja 7) | 8.8 | 11.2 | 2.7 | -1.3 | -1.5 | -0.5 | 2.3 | 1.5 | 0.4 | |
| Blerjet e mëdha aktuale (pyetja 8, komponent i TBK-së) | -65.7 | -62.7 | -62.3 | -58.8 | -60.1 | -57.9 | -61.4 | -61.3 | -61.4 | |
| Blerjet e mëdha pritje (pyetja 9, komponent i TBK-së) | -47.0 | -52.0 | -48.5 | -47.9 | -48.6 | -47.3 | -47.7 | -49.3 | -48.7 | |
| Kursimi aktual (pyetja 10) | -48.2 | -50.3 | -44.4 | -41.9 | -42.6 | -43.3 | -45.2 | -44.0 | -45.4 | |
| Kursimi pritje (pyetja 11) | -41.9 | -44.0 | -40.0 | -39.9 | -39.5 | -39.3 | -42.6 | -43.3 | -43.7 | |
| Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve (pyetja 12) | 1.7 | 3.2 | 4.2 | 3.4 | 4.2 | 2.8 | 0.1 | -0.8 | -1.1 | |

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

ANEKS

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për aggregimin e të dhënave cilësore nga vrojtimet. Ajo llogaritet si diferençë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve, të cilat kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para aggregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.